

Nr.regj. 18214/2012

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK / DMP	Nr. Prot. 03-3085/12
Dep. DPK / DMP	Prot No. 03-3085/12
Nr. i faq. 02	Data 03.09.2012
Prishtinë	

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Rexhep Kasumaj nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 parag.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, Nr.04/L-050, në bazë të nenit 73,74,195,199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZK 23/79, me datë **17.08.2012** merr këtë:

AKTVE N D I M

I PANDEHURI: Rexhep Brahim Kasumaj, i lindur më 23.03.1955 në fshatin Gllogjan, tani jeton në Prishtinë, me vendbanim në lagjen "Mati III" pn., Drejtor i Klinikës së Urologjisë në QKUK në Prishtinë, me shkollim superior, i martuar, babë i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike,

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s

Sepse, si Zyrtar i Lartë Publik, në pozitë të Drejtorit të Klinikës së Urologjisë në QKUK në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarin e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor deri më 31.03.2012,

- **me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 parag.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik**, andaj të pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

D Ë N I M I

Me gjobë në shumë prej 2000€ (Dymijë Euro) të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formë e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së No.1000 4300 7000 0518. Pagesa bëhet në ndonjë agjenci për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh, duke llogaritur nga 15 Euro për një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumë prej **5 Euro** në shërbimin e arkës së gjykatës.

Nga një kopje e këtij aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtrroi kësaj gjykate Kërkesën 01-1807/2012 me datë 22.05.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartshënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se e pranon kundërvajtjen e cila i vihet në barrë duke shtuar se edhe vitin e kaluar duke qenë drejtor i Klinikës së Urologjisë, ka bërë deklarin e pasurisë, por nga atëherë ka pasur një parizë në faqen e djathtë të fytyrës dhe nuk ndihej mirë me shëndet prandaj këtë vit nuk ka arritur të bëjë deklarin e rregullt të pasurisë brenda afatit ligjor, por këtë e ka bërë me vonesë, saktësisht me datë 21. 06.2012 që e dëshmon me vërtetim të Agjencisë. Në vazhdim i pandehuri shton se ka qenë i

03-3085/12/02
fuz

njoftuar me kohë ndonëse nuk i kujtohen detajet, pastaj shton se gjatë tërë muajit mars ka qenë në punë si dhe në fund jep konstatimin se nuk e sheh të arsyeshme faktin pse drejtorët e klinikave do duhej të deklarojnë pasurinë derisa janë të zhveshur nga kompetencat buxhetore në klinika.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së të pandehurit dhe shqyrtimi i shkresave të tjera të lëndës, administrimi i secilës veç e veç dhe të gjitha së bashku, gjyqtarja në masë të mjaftueshme vërtetoi gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike, ekzistimin e veprës kundërvajtëse dhe përgjegjësisë së të pandehurit për këtë kundërvajtje, meqë i njëjti nuk e ka respektuar afatin e dhënë ligjor për deklarim të rregullt të pasurisë dhe se përkundër sëmundjes së parizës në fytyrë që e kishte pësuar një vit më herët, i njëjti gjatë tërë muajit mars ka qenë në punë dhe kjo konsiderohet si gjendje e mirë shëndetsore, e përshtatshme për punë dhe për ushtrimin e aktiviteteve zyrtare përfshirë edhe deklarimin e pasurisë dhe dorëzimin e deklaratimit qoftë personalisht apo nëpërmjet personit të tretë të autorizuar. Faktin se a do duhej apo jo drejtorët e klinikave të obligohen për deklarimin e pasurisë, gjyqtarja nuk e vlerësoi fare, ngase një gjë e tillë është e paraparë me ligj dhe nuk don koment shtesë përveç se zbatim të përpikët, andaj për kundërvajtjen e kryer i shqiptoi dënimin e paraparë ligjor.

Gjatë shqiptimit të dënimit gjyqtarja pati parasysh rrethanat nga neni 7 i LK në të cilat është kryer kundërvajtja dhe sipas peshës së kundërvajtjes e shkallës së përgjegjësisë së pandehurit, e duke vlerësuar edhe personalitetin e të pandehurit e gjendjen materiale, të njëjtin e dënoi me dënimin me gjobë të precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me bindje se edhe me një gjobë të tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit dhe se i pandehuri në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e ndonjë kundërvajtjeje të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr.regj.18214/2012, datë 17.08.2012

Gjyqtarja
Suzana Çerkini

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.

